

VENDIM
Nr. 220, datë 13.4.2022

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “SISTEMIM I LAGJES “29 MARS”, BLOKU “ZJARRFIKËSJA”, PATOS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemim i lagjes “29 Marsi”, blloku “Zjarrfikësja”, Patos”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Patos.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit “truall” dhe “godinë ekonomike”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 569 618.16 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë pikë gjashtëmbëdhjetë) lekësh.

4. Masa e shpërblimit për pronarët që shpronësohen është 1 569 618.16 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë pikë gjashtëmbëdhjetë) lekë dhe përballohet nga buxheti i Bashkisë Patos.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Patos.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues, për likuidim, pranë Bashkisë Patos.

8. Bashkia Patos kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Patos.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe bën regjistrimin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Bashkisë Patos.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimi i kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Patos për pasuritë e shpronësuar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Patos, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA PËRFUNDIMTARE E PRONARËVE PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I PROJEKTTIT “SISTEMIM
LAGJJA 29 MARS, BLOKU ‘ZJARRFIKËSJA’, PATOS

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	ZK	Nr. i pasurisë	Sipërf. e përgj. truall m ²	Sipërf.e prekur truall m ²	Çmimi për truall (lekë/m ²)	Vlera e truallit	Funks.i godinës	Sipërf. e ndërtesës m ²	Sipërf. e prekur ndërtesës m ²	Çmimi njësi m ² /banesa	Përqindja e amortizimit	Vlera e ndërtesës	Vlera e përgjithshme	Shënime
1	Kujtim Hoxha	2890	1/50	64	64	2848	182,272.00		0	0				182,272.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Kujtim Hoxha	2890	1/77	35	35	2848	99,680.00	Godine ekonomike 1-katëshe +1 kat nëntokë	35.5	35.5	28000	21%	1,287,666.2	1,387,346.16	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Vlera totale													1,569, 618.16	